

Deloitte.

**Instituti për Studime të Avancuara
GAP**

Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Përmbajtja

Faqe

Raporti i Auditorit të Pavarur

4

Pasqyra e Pozicionit Financiar

5

Pasqyra e Fitimit apo e Humbjes dhe e të Ardhurave tjera gjithëpërfshirëse

6

Pasqyra e Rrjedhës së Parasë

Shënimet për Pasqyrat Financiare

7 – 14

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Bordin e Drejtorëve dhe Menaxhmentin e “Instituti për Studime të Avancuara GAP”

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të “Institutit për Studime të Avancuara GAP” (“Organizata”), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financier më 31 dhjetor 2017, pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të hyrave tjera gjithëpërfshirëse dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar në atë datë, dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare dhe një përbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të bashkangjitura paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financier të Organizatës me 31 dhjetor 2017, përformancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në atë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Bazat për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Nderkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona nën këto standarde janë të sqaruara më tutje në seksionin e këtij raporti, Përgjegjësitë e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët, Kodi i Etikës për Profesionistët (Kodi BSNEP) dhe me kërkesat etike të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare në Kosovë dhe ne kemi përbushur edhe përgjegjësitë tona tjera financiare në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi mbledhur është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe atyre që janë ngarkuar me qeverisje për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF dhe për kontrollat e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare të cilat nuk përbajnë anomali materiale nga mashtrimi apo edhe gabimet.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Organizatës për të vazhduar me tutje, duke shpalosur, nëse e aplikueshme, çështje që lidhen më vazhdimësinë e biznesit dhe përdorin parimin e vazhdimësisë së biznesit, përvèç kur menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë kompaninë ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka ndonjë mundësi tjeter përvèç se të veprojë në këtë mënyrë.

Të ngarkuarit me qeverisje janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

Deloitte.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Qëllimi jonë është marrja e sigurisë së arsyeshme që pasqyrat financiare si tërësi nuk përbajnë anomali materiale, qoftë si pasojë e mashtrimeve ashtu edhe e gabimeve dhe lëshimin e një raporti të auditorëve i cili përmban opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garacion i asaj që një auditim i kryer në përputhje me SNA, do të detektojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të lindin nga mashtrimet ose gabimet dhe konsiderohen materiale nëse individualisht, ose të bashkuara, mund të pritet në mënyrë të arsyeshme që të ndikojnë në vendimet ekonomike të shfrytëzuesve të pasqyrave financiare, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë riskun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, si pasojë nga mashtrimet apo edhe si pasojë e gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedura të auditimit të cilat i përgjigjen këtyre risqeve dhe marrim evidenca të auditimit të cilat janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Risku i mos-zbulimit të një anomalie materiale e cila rrjedhë nga mashtrimi është më i madh sesa i atij që rrjedhë nga gabimi, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterepretime, ose shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brëndshëm i cili është i rëndësishmëm për auditimin në mënyrë që të dizajnohen procedura të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrëthanat, por jo për qellim të shprehjes së një opinioni lidhur me efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Organizatës.
- Vlerësojmë përshtatshmerinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmerinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosje të ngjashme të bëra nga menaxhmenti.
- Bazuar në evidencën e siguruar, vendosim mbi përshtatshmërinë e shfrytëzimit të parimit të vazhdimesisë së biznesit dhe nëse një pasiguri materiale egziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të vënë në dyshim aftësinë e Organizatës për të vazhduar me tutje. Nëse ne konkludojmë se një pasiguri materiale egziston, jemi të detyruar të tërheqim vëmendje në reportin tonë lidhur me këtë shpalosje në pasqyrat financiare, ose nëse shpalosjet e tillë nuk janë të duhurat, të modifikohet opinioni jonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të mbledhur deri me datën e raportit finanziar. Sidoqoftë, kushtet ose ngjarjet në të ardhmen, mund të shkaktojnë që Organizata të ndërprenë vijushmërinë e biznesit.
- Vlerësimi i prezantimit të përgjithshëm, strukturës dhe përbajtjes së pasqyrave financiare, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet themelore dhe ngjarjet në mënyrë që të arrijnë paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen, mes tjera, fushëveprimin e planifikuar dhe kohën e auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollat e brendshme të cilat i identifikojmë gjatë auditimit.

Deloitte Kosova sh.p.k.

Deloitte Kosova sh.p.k.
Rr. Lidhja e Pejes, nr.177
Prishtinë, Republika e Kosovës
Nr i regjistrimit: 80452632
28 Mars 2018

Ky raport është përkthim i versionit original në gjuhën angleze, në rast mospërputhjeje midis këtyre dy raporteve, raporti në gjuhën angleze do të mbizotërojë.


Instituti për Studime të Avancuara GAP

Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2017 (shumat në Euro)

	Shënime	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Pasuritë			
Paraja në arkë dhe në banka	6	96,924	75,568
Pasuritë afatshkurtëra		<u>96,924</u>	<u>75,568</u>
 Pajisjet për zyrë	5	14,416	5,327
Gjithsej pasuritë afatgjata		<u>14,416</u>	<u>5,327</u>
 Gjithsej pasuritë		<u>111,340</u>	<u>80,895</u>
 Detyrimet dhe Kapitali			
Balanca hapëse			-
Teprica Neto			-
Gjithsej Kapiali			-
 Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	7	5,567	5,023
Të ardhurat e tjera	8	<u>105,773</u>	<u>75,872</u>
Gjithsej detyrimet afatshkurtëra		<u>111,340</u>	<u>80,895</u>
 Gjithsej detyrimet dhe kapitali aksionar		<u>111,340</u>	<u>80,895</u>

Këto pasqyra financiare janë aprovuar për publikim nga Bordi i Drejtoreve me 28 Mars 2018 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:


Nora Latifi Jashari
Drejtoreshë Ekzekutive


Nita Tafarshiku
Kontabiliste Financiare

Instituti për Studime të Avancuara GAP

**Pasqyra e Fitimit apo e Humbjes dhe e të Ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017
(shumat në Euro)**

	Shëni me	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016
Të ardhurat nga donacionet	9	<u>262,915</u> 262,915	<u>237,018</u> 237,018
Shpenzimet e programit dhe administrative	10	<u>262,915</u> 262,915	<u>237,018</u> 237,018
Teprica operative		-	-
Fitimi para shpenzimeve të tatimit mbi të ardhurat		-	-
Tatimi mbi fitimin		-	-
Teprica/(mungesa) neto për vitin		-	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		-	-

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Pasqyra e Rrjedhës së Parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017
(shumat në Euro)

	Shënime	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016
Fitimi neto për vitin përparrat tatimit mbi të ardhurat	-	-	-
Përmirsimet për:			
Zhvlerësim	5,295	3,353	
Lëvizja në kapitalin punues:			
(Zvogëlimi)/Rritja në të pagueshmet tregtare dhe të tjera	546	1,059	
(Zvogëlimi)/Rritja në të ardhurat e shtyra	29,899	(19,216)	
	35,740	(14,804)	
Tatimi mbi të ardhurat i paguar	-	-	
Paraja neto e përdorur në aktivitetin operacional	35,740	(14,804)	
AKTIVITETET INVESTUESE			
Shtesat në asetet fikse	(14,384)	-	-
Paraja neto e përdorur në aktivitetin investues	(14,384)	-	-
AKTIVITETET FINANCUESE			
Paraja neto e përdorur në aktivitetin financues	-	-	-
Zvogëlimi neto në para dhe ekuivalentët e saj	21,356	(14,804)	
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	75,568	90,372	
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund te vitit	96,924	75,568	

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Euro, përvèç nëse deklarohen ndryshe)

1. Informatat të përgjithshme

Instituti për Studime të Avancuara GAP është e regjistruar si organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse sipas Ligjit 03/L-134 mbi Lirinë e Asocimit të Organizatave Jo-Qeveritare, më 17 Gusht 2007 me zyre qëndrore në Prishtinë.

Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think Tank i Kosovës qëllimi kryesor i të cilit është të tërheq profesionistë për të krijuar një hulumtim profesional dhe ambient të zhvilluar që haset në institucionë të ngashme në shtetet perëndimore.

Kjo do të përfshijë sigurimin e kosovarëve me një mundësi për hulumtim të zhvilluar dhe për të implementuar projekte që do të forconin shoqërinë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbushë zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

2 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet e mëposhtme, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit janë efektive për periudhën aktuale:

- **Ndryshimet në SNK 7 "Pasqyra e rrjedhës së parasë"** - Iniciativa për shpalosjet (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017),
- **Ndryshimet në SNK 12 "Tatimi mbi të Ardhurat"** - njohja e aktiveve tatimore të shtyra për humbjet e parealizuara (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017)
- **Ndryshimet në SNRF 12 për shkak të "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2014-2016)"** që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 12 dhe SNK 28) kryesisht me qëllim për heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e formulimeve (Ndryshimi i SNRF 12 që do të aplikohen për periudha vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017).

Adoptimi i këtyre ndryshimeve në standardet egzistuese dhe interpretimet nuk kanë çuar në ndryshim të ndonjë politike të kontabilitetit të Organizatës.

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Euro, përvèç nëse deklarohen ndryshe)

3. Standardet dhe interpretimet e lëshuara që nuk janë ende efektive

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet, rishikimet dhe interpretimet në vijim ishin lëshuar, por ende joefektive:

Standardet dhe interpretimet që janë lëshuar, por që nuk janë ende efektive, deri në datën e nxjerrjes së pasqyrave financiare të Bankës janë dhënë më poshtë. Banka synon të miratojë këto standarde, nëse është e aplikueshme, kur ato të hyjnë në fuqi.

- **SNRF 9 "Instrumente financiare"** (efektive për periudha vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2018),
- **SNRF 15 "Të ardhura nga kontratat me klientë"** dhe ndryshime të metutjeshme (efektive për periudha vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2018)
- **SNRF 16 "Qiratë"** (efektive për periudha vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),
- **SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021),
- **Ndryshime në SNRF 2 "Pagesat e bazuara në aksione"** – Klasifikimet dhe Matjet e transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione (efektive për periudha vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2018),
- **Ndryshime në SNRF 4 "Kontratat e Sigurimeve"** - Zbatimi i SNRF 9 "Instrumentet Financiarë" me SNRF 4 "Kontratat e Sigurimeve" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018 ose kur SNRF 9 "Instrumentet Financiarë" aplikohet për herë të parë),
- **Ndryshime në SNRF 9 "Instrumentet Financiare"** - Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),
- **Ndryshime në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta"** - Shitia ose Kontributi i Pasurive midis një Investitori dhe Bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët dhe ndryshimeve të mëtejshme (data efektive shtyhet për një kohë të pacaktuar deri kur projekti kërkimor mbi metodën e kapitalit të jetë përfunduar),
- **Ndryshime në SNK 19 "Përfitimet e punonjësve"** - Ndryshimi i planit, shkurtimi ose shlyerja (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),
- **Ndryshime në SNK 28 "Investimet në Shoqëri dhe Sipërmarrje të Përbashkëta"** - Interesat afatgjata në shoqëri dhe sipërmarrje të përbashkëta (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2019),
- **Ndryshime në SNK 40 "Prona e investuar"** - Transferet e Pronës së Investimit (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- **Ndryshime në SNRF 1 dhe SNK 28 për shkak të "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2014-2016)"** që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 12 dhe SNK 28) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e formulimit (ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28 duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2018),
- **Ndryshime në disa standarde për shkak të "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2015-2017)"** që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve (SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e formulimit (efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2019),
- **KIRFN 22 "Transaksionet në monedhë të huaj dhe Konsiderata paraprake"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2018),
- **KIRFN 23 "Pasiguria mbi Trajtimin e Taksave mbi të Ardhurat"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2019).

Kompania ka zgjedhur të mos miratojë këto standard, rishikime dhe interpretime përpëra datave efektive të tyre. Kompania parashikon që adoptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë në periudhën aplikimit fillestar.

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Euro, përveç nëse deklarohen ndryshe)

4. Përbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

4.1 Bazat e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur nën parimin e kostos historike, përveç rivlerësimit të pasurisë dhe detyrimeve financiare të caktuara.

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Euro, e cila është monedha funksionale e organizatës.

4.2 Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë të hollat në dorë dhe paratë e pakushtëzuar me bankat ose depozitat me afat maturimi më pak se tre muaj.

4.3 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose për t'u arkëtuar dhe përfaqëson vetëm shumën e arkëtueshme nga donatorët në lidhje me listën e pagave, dhe shpenzimet operative dhe shpenzimeve tjera të shkaktuara.

4.4 Transaksionet në valuta të huaja

Transaksionet në valuta të ndryshme nga valuta funksionale (valutë të huaj) regjistrohen në normat e këmbimit që mbizotërojnë në datat e transaksioneve. Në çdo datë raportimi, zërat monetarë të shprehur në valutë të huaj konvertohen në normat mbizotëruese në datën e raportimit. Zërat jo-monetary që maten me kosto historike në valutë të huaj nuk ripërkthehen. Diferencat e këmbimit që rrjedhin nga zërat monetarë, janë të përfshira në fitimin dhe humbjen e periudhës në të cilën ato lindin.

4.5 Përfitimet e punonjësve

Organizata nuk ka përgjegjësi shtesë për pensionet e punëtorëve përveç pagesës së kontributeve pensionale në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

4.6 Kontigjencat dhe provizonet

Detyrimet kontigjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato shpalosen përveç nëse mundësia e rrjedhës së mjeteve që trupëzojnë përfitime ekonomike është e largët. Një pasuri kontigjente nuk njihet në pasqyrat financiare por shpaloset kur hyrja e përfitimeve ekonomike është e mundshme.

Një provizion është i njohur atëherë kur Organizata ka një detyrim të pranishëm (ligjor ose strukturor) si rezultat i një ngjarje të kaluar dhe është e mundshme që një rrjedhje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të kërkojen për të shlyer detyrimin, dhe një vlerësim i besueshëm mund t'i bëhet shumës së detyrimit.

4.7 Gjykime kritike kontabël dhe burimet kryesore të pasigurisë në vlerësim

Në procesin e zbatimit të politikave kontabël të kompanisë, të cilat janë të përshkruara më sipër, menaxhmenti nuk ka bërë asnjë gjykim i cili ka efekte të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Euro, përveç nëse deklarohen ndryshe)

5. Pajisjet e zyrës

	Pajisjet e zyrës	Gjithsej
<i>Kosto</i>		
Balanca më 1 Janar 2015	13,262	13,262
Shtesat	6,600	6,600
Nxjerrje jashtë përdorimit	(2,758)	(2,758)
Balanca më 31 dhjetor 2015	17,104	17,104
Shtesat	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-
Balanca më 31 dhjetor 2016	17,104	17,104
Shtesat	14,384	14,384
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-
Balanca më 31 dhjetor 2017	31,488	31,488
<i>Zhvlerësimi i akumuluar</i>		
Balanca më 1 janar 2015	7,760	7,760
Shpenzimi për vitin	3,421	3,421
Nxjerrje jashtë përdorimit	(2,757)	(2,757)
Balanca më 31 dhjetor 2015	8,424	8,424
Shpenzimi për periudhën	3,353	3,353
Balanca më 31 dhjetor 2016	11,777	11,777
Shpenzimi për vitin	5,295	5,295
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-
Balanca më 31 dhjetor 2017	17,072	17,072
Balanca më 31 dhjetor 2015	8,680	8,680
Balanca më 31 dhjetor 2016	5,327	5,327
Balanca më 31 dhjetor 2017	14,416	14,416

6. Paraja në arkë dhe në bankë

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
TEB Euro	96,663	75,290
TEB USD	77	77
PROCREDIT Bank	1	5
Paraja në arkë	183	196
Gjithsej	96,924	75,568

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Euro, përvèç nëse deklarohen ndryshe)

7. Të pagueshmet tregtare dhe të tjera

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Shpenzimet rrjedhëse	2,583	2,560
Tatimi i pagueshëm I mbajtur	2,875	2,354
Tatimi në qera	109	109
Gjithsej	5,567	5,023

8. Të hyrat e shtyra

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Të hyrat e shtyra	105,773	75,872
Gjithsej	105,773	75,872

9. Të ardhurat nga donacionet

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016
SIDA	76,875	68,210
Rockefeller Brothers Fund	22,043	44,932
National Endowment for Democracy	29,526	43,759
British Embassy	-	25,675
UNDP	24,910	12,080
Open Society Foundations	3,927	7,884
KCSF	39,229	4,302
ATRC	35,913	2,658
OSIFE	-	1,493
The International Research and Exchange Board (IREX)	-	1,053
MATRA	842	-
US Embassy	15,570	-
WEBER	6,296	-
Main/Other	7,784	24,972
Gjithsej	262,915	237,018

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Euro, përveç nëse deklarohen ndryshe)

10. Shpenzimet e programit dhe administrative

	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2016
Pagat dhe përfitimet	142,732	132,827
Tatimi mbi të ardhurat dhe kontributet	15,743	19,118
Qiraja dhe tatimi në qira	14,505	14,505
Kostot e dizajnit	4,933	11,719
Tarifa profesionale	940	7,949
Reklama	6,904	6,138
Mirëmbajtja e webfaqes dhe zyrës	6,540	5,819
Tryeza të rrubmullakta	6,916	5,362
Shërbimet e hulumtimeve	-	5,000
Tarifat e auditimit	1,900	3,500
Shpenzimet e udhëtimit	10,206	3,483
Zhvlerësimi	5,295	3,354
Shërbimet e përkthimit	11,105	2,907
Kostot e printimit	4,678	2,524
Shpenzimet komunale	1,728	1,358
Shpenzimet e komunikimit	1,416	1,238
Furnizimet e zyrës	1,310	1,101
Mëditjet	-	650
Abonimet	375	584
Tarifat Bankare	628	427
Shërbimet e takimit për projekt	930	-
Shpenzimet e vlerësimit	6,825	-
Anketa	9,530	-
Të tjera	7,776	7,455
Total	262,915	237,018

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Euro, përvèç nëse deklarohen ndryshe)

11. Transaksionet e palëve të ndërlidhura

Palët janë të lidhura në qoftë se njëra palë ka aftësinë për të kontrolluar palën tjetër ose të ushtrojë ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operacionale. Kur konsiderohet çdo marrëdhënie ndërmjet palëve, vëmendje i kushtohet substancës së marrëdhënieve, jo thjesht me formën ligjore.

Transaksionet e palëve të ndërlidhura janë kryer në kushte normale komerciale dhe me çmimet e tregut. Tabela në vijim përbledhë transaksionet dhe balancat për vitet e përfunduara më 31 dhjetor 2017 dhe 2016:

	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2016
Kompenzimi kyq i menaxhmentit		
Pagat	81,960	77,960

12. Vlera e drejtë dhe menaxhimi i riskut

a. Politika të rëndësishme kontabël

Detajet e politikave të rëndësishme kontabël dhe metodave të adoptuara, duke përfshirë kriteret për njohje, në bazë të matjes dhe bazën mbi të cilën të ardhurat dhe shpenzimet njihen, në lidhje me secilën klasë të pasurisë financiare, detyrimit financier dhe instrumentet e kapitalit janë shpalosur në shënimin 4 të pasqyrave financiare.

b. Kategoritë e instrumenteve financiare

Në fund të vitit Organizata ka këto instrumente financiare:

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
<u>Pasuritë financiare:</u>		
Paraja në arkë dhe bankë	96,924	75,568

c. Objektivat e menaxhimit të rrezikut financiar

Aktivitetet e organizatës e ekspozojnë atë në një shumëlojshmëri të rreziqeve financiare, duke përfshirë rrezikun e kredisë dhe rreziqet që lidhen me efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit në valutë të huaj dhe normat e interesit. Menaxhimi i riskut të organizatës fokusohet në paparashikueshmërinë e tregjeve dhe kërkon të minimizojë efektet e mundshme negative mbi ecurinë e biznesit të Organizatës.

Menaxhimi i riskut kryhet nga menaxhmenti në bazë të disa politikave të para-aprovuar me shkrim dhe procedurave që mbulojnë menaxhimin e përgjithshëm të riskut, si dhe fusha të veçanta, të tillë si rreziku këmbimit valutor, rreziku i normës së interesit, rrezikut të kredisë, përdorimin e letrave me vlerë të duhura dhe investimi në likuiditet të tepërt.

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Euro, përveç nëse deklarohen ndryshe)

12. Vlera e drejtë dhe menaxhimi i riskut (vazhdim)

d. Rreziku i tregut

Rreziku i valutës së huaj

Organizata vepron ndërkombëtarisht dhe është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit që rrjedh nga ekspozimet e ndryshme në valutë kryesisht në lidhje me dollar. Organizata nuk përdor ndonjë instrument për të mbrojtur rrezikun e këmbimit të huaj. Menaxhmenti i organizatës është përgjegjës për të mbajtur pozitën e duhur neto në çdo monedhë dhe në total dhe operacionet e saj janë të monitoruara çdo ditë nga drejtuesit e Organizatës.

Organizata ndërmerr transaksione në Euro dhe valuta të huaja. Organizata nuk ka hyrë në ndonjë transaksion të këmbimit forward ose derivative për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017.

e. Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit lind në financimin e përgjithshëm të aktiviteteve të organizatës dhe në menaxhimin e pozicioneve. Ai përfshin edhe rrezikun e të qenit në gjendje për të financuar asetet në pjekurinë e duhur dhe normat dhe rrezikun e të qenit në gjendje për të likuiduar një pasuri, me një çmim të arsyeshëm dhe në një kuadër të përshtatshëm kohor për të përmbushur detyrimet.

f. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Menaxhmenti i Organizatës konsideron se vlerat kontabël të aseteve financiare dhe detyrimeve financiare të regjistruara me kosto ose kosto të amortizuar në pasqyrat financiare ngajnjë me vlerën e tyre reale për shkak të maturitetit të tyre të shkurtër.

13. Ngjarjet pas dates raportuese

Nuk ka ndonjë ngjarje të rëndësishme pas datës raportuese që mund të kërkojnë përshtatje ose shpalosje në pasqyrat financiare të Organizatës.